

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-55219
Më 20.5.2014

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për mbështetje financiare për shënimin e 31 Majit–Ditës Ndërkombëtare kundër pirjes së duhanit, kryetari i Komunës, më 20 maj 2014, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, i datës 13.5.2014 për mbështetje financiare për shënimin e 31 Majit – Ditës Ndërkombëtare Kundër Pirjes së Duhanit, kështu që, për këtë qëllim, lejohen mjete në lartësi prej 1500 €.

Ky projekt do të implementohet nga Këshilli Rinor, në bashkëpunim me organizata të tjera rinore, Këshill i nxënësve, Qendrën e Rinisë, PMSH-në etj., dhe do të monitorohet nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Ky projekt del nga komponenta 4 të Politikave Rinore.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve i Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja